**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**
**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**
**TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE**
**PROCUREMENT REVIEW BODY**

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

**OSHP: 2023/0551**

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Vedat Poterqoi - Kryetar, panelist individual, duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) N.T.P.,,Bletaria Egzoni", kundër Vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit të KUVENDI KOMUNAL FUSHË KOSOVË në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit Blerja e pajisjeve bletare me numër të prokurimit 612-23-6052-1-2-1, me 09/10/2023, mori:

# Vendim

**1. Aprovohet,** si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik "Bletaria Egzoni" N.T.P., e parashtruar në Organin Shqyrtues të Prokurimit me 07.08.2023 (me numër protokolli 551/23) për aktivitetin e prokurimit me titull: "Blerja e pajisjeve bletare " me nr. të prokurimit:612-23-6052-1-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna Fushe Kosove.

**2. Të anulohet** njoftimi për dhënie të kontratës dhe lënda të kthehet në rivlerësim.

3.Lejohet kthimi i shumës së deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës dhe obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

# Arsyetim

*- Faktet dhe rrethanat procedurale –*

Me 13.06.2023, Komuna Fushe Kosove , në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar njoftimin për kontratë për aktivitetin e prokurimit me titull: "Blerja e pajisjeve bletare" me nr. të prokurimit: 612-23-6052-1-2-1 Nderkaq me datën 06.07.2023 eshte publikuar njoftimi mbi vendimin e AK.

OE"Bletaria Egzoni" N.T.P, me datën 24.07.2023 ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim në AK. AK- Komuna Fushe Kosove me vendim ka refuzuar kërkesën per rishqyrtim te OE"Bletaria

Egzoni" N.T.P.. lidhur me aktivitetin e prokurimit "Blerja e pajisjeve bletare" me numër te prokurimit: 612-23-6052-1-2-1 inicuar nga – Komuna Fushe Kosove.

AK ne vendim ka kërkuar te mbetet ne fuqi njoftimi mbi vendimin per dhënie i AK – Komuna Fushe Kosove lidhur me aktivitetin e prokurimit "Blerja e pajisjeve bletare" me numër te prokurimit:" 612-23-6052-1-2-1 ".

I pakënaqur me vendimin e AK-së, OE"Bletaria Egzoni" N.T.P.. ankuesme datën 07.08.2023 ka parashtruar ankesë në OSHP, me numër të protokollit 551/23, kundër vendimit të Autoritetit Kontraktues lidhur me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedure te hapur, lloji i kontratës: Furnizim, vlera e parashikuar e kontratës:15,000.00 €.

Ankesa e OE është ushtruar në pajtim me nenin 109.1, të LPP, sipas të cilit kundër çdo vendimi të marrë nga AK çdo palë e interesuar mund të parashtrojë ankesë pranë OSHP. Meqë OE ka ushtruar po ashtu kërkesë për rishqyrtim, do të thotë se veprimet e të njëjtit i referohen po ashtu dhe nenit 108/A të Ligjit të cituar. Prandaj OSHP konsideron se Ankesa i plotëson kushtet e parapara në kuptim të dispozitave tani më të cituara dhe e njëjta bie nën kompetencat e tij në kuptim të nenit 105, të LPP.

***- Vlerësimi dhe administrimi i provave*** –

Bazuar në veprimet e përshkruara si më sipër, OSHP ka angazhuar ekspertin vlerësues në pajtim me nenin 111, paragrafi 5 të LPP, me detyrë që i njëjti në kuptim të nenit 113 të Ligjit të cituar, ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore, përkitazi me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër. Lidhur me ketë, me 17.08.2023 eksperti shqyrtues ka dorëzuar Raportin e vlerësimit me rekomandimet si në vijim:

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE "Bletaria Egzoni" N.T.P.

**Të aprovohet si e bazuar**, si dhe **të anulohet** njoftimi për dhënie të kontratës dhe lënda të kthehet në rivlerësim.

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES

• **Sqarim hyrës**: Autoriteti kontraktues (AK) – KUVENDI KOMUNAL FUSHË KOSOVË gjatë këtij aktiviteti të prokurimit ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës furnizim, vlerë e mesme, kriteri i dhënies së kontratës tenderi i përgjegjshëm me çmimi më të ulët vlera e parashikuar e kontratës: 15,000.00€.

Pretendimi kryesor ankimor ka të bëjë kundër propozimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues.
**Përgjigje në Pretendimet ankimore:**
Pas administrimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës kundrejt pretendimit ankimore, operatori ekonomik "Bletaria Egzoni" Gjakovë më tej si parashtrues i ankesës, se OE i rekomanduar për kontratë N.T.P "Bajra", lidhur me A-testet, **sqarim:** gjatë fazës së tenderimit për A –teste janë kërkuar me sqarime të dosjes së tenderit me datë: 20/06/2023 nga OE "Bletaria Egzoni" citoj pyetjen e OE-

së: 3.Nese Bazamenti Antivaro është nga plastika a kërkohen A-Testet e kryera për plastiken dhe me datën: 20.06.2023 Autoriteti Kontraktues (AK) ka kthyer përgjigjen si citoj: 3. Bazamenti anti varo plastik duhet të ketë A testin e kryer për plastik.
Duke e parë të gjithë materialin lidhur me këtë pretendim vërej se AK nuk e ka bënë Njoftimin për informata shtesë ose përmirësim gabime duke përdorur formularin standard B54 në harmoni me neni Nenin, 24 Ofrimi i informacioneve shtesë ose sqarimeve sipas RREGULLORES NR. 001/2022 PËR PROKURIMIN PUBLIK. Por në këtë rast sqarimet të cilat janë bërë nga AK behën pjesë e dosjes së tenderit në cilën do formë.
Ndera lidhur me kërkesë për sqarime në raport me OE për A testet në platformën elektronike nuk ka mundur ti hasi. Por A testet figurojnë në platformën elektronike të cilat i ka bashkangjitur OE i rekomanduar për kontratë pas hapjes së ofertave, A testet janë bashkangjitur me datë: 14.07.2023 dhe për mendimin e ekspertit shqyrtues pranimi i A testeve në formë të tillë përben ndryshmi substancial dhe material.
Ndërsa AK me datë: 25.07.2023 përmes B47 Letër Standarde e kërkesës për sqarimin e tenderit ka kërkuar sqarim nga OE fitues vetëm për dy projektet e më poshtme: citoj pyetjet e AK –së:

Për të vlerësuar tenderin e juaj në mënyrë të duhur, ne kërkojmë që të siguroni sqarimin e tenderit të juaj si në vijim:

Kerkojm nga ju qe te na ofroni dëshmi kontratën dhe dëshmi nga banka per projektin "Furnizim me pajisje per bujqësi dhe blegtori" (OE Famis-CO-HC).
Kerkojm nga ju qe te na ofroni dëshmi kontratën dhe dëshmi nga banka per projektin "Furnizim me koshere per blete" (OE Komtel Project Engineering)

Sipas letrës standarde B47, AK nuk ka kërkuar sqarime për A-teste dhe pranimi i A testit nga OE pas hapjes së ofertave sipas LPP – Neni 72 Dokumentacionidhe informacionishtesë. 3. Sigurimi i informacionit qe mungon ose ofrimi i informacionit do të aplikohet vetëm për dokumentet ekzistenca e të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive. RRUOPP: 39.2 Asnjë ndryshim në çmim ose kusht tjetër material ose aspekt të tenderit nuk mund të kërkohet, ofrohet ose lejohet. 39.3 Megjithatë, lejohet qe një autoritet kontraktues gjatë vlerësimit të kërkoj dhe të marrë informacione apo dokumente, të cilat mungojnë ne aplikacion/tender. Këto dokumente, megjithatë, ne mënyre objektive duhet të prezantojnë prova të mjaftueshme që në mënyrë të arsyeshme pasqyrojnë gjendjen ekzistuese para datës se publikimit të Njoftimit për kontrate.

- Andaj, ky pretendim ankimor nga "Bletaria Egzoni" është i bazuar për ekspertin shqyrtues.

Sa i përket pretendimit ankimor të parashtruar nga "Bletaria Egzoni" Gjakovë lidhur me neni 10.3 të LPP –së se AK nuk ofruar dokumentacionin rreth kërkesa eventuale për sqarime. Pas shqyrtimit të pretendimit ankimor dhe verifikimit në sistemin elektronik (e-prokurimi) vërejmë se OE ankues ka bërë kërkesë për qasje në dokumente zyrtare me datë: 18.07.2023 përmes e-malit ku AK ka ofruar qasje konform nenit 10 të LPP –së dhe duke u bazuar se në proces verbalin i cili është mbajtur nga AK ku potencohet edhe në proces verbal se Operatorit Ekonomik, (citojmë pjesën e fundit të procesverbalin), "OE si kopje mori dokumentacionin me ane të USB për të gjithë OE që ka ofertuar ne ketë aktivitet të prokurimit, ashtu siç e ka kërkuar me anë të kërkesës" po ashtu proces verbali është nënshkruar nga dy palët dhe nënkupton se OE ka pranuar dokumentet konform kërkesë së bërë.

- Duke u bazuar në të gjitha pikat e larë përmendura dhe fakteve në sistemin elektronik ky pretendim ankimor për ekspertin shqyrtues është i pa bazuar.

Pas administrimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës kundrejt pretendimit ankimore, operatori ekonomik "Bletaria Egzoni" Gjakovë më tej si parashtrues i ankesës lidhur me kërkesë e dosjes së tenderit tek pjesa Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1 & 9.2 është kërkuar: **Kapaciteti teknik dhe professional** 1.Operatori Ekonomik duhet të ofroj dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të natyrës së ngjajshme në tri (3) vitet e fundit nga data e publikimit te njoftimit per kontrate në vlerë prej min. 22 500 euro. Ne rast te grupit lideri duhet ti ketë se paku 60 % te shumes se kërkuar furnizime te natyrës se ngjajshme **Dëshmia e kërkuar dokumentare:** 1.Një listë të kontratave të realizuar ne tri vitet e fundit duke saktsuar produktet e perfshira, shumen e kontrates, daten dhe pranuesit te përcjella me referenca përkatëse ose proceset e pranimeve për projektet e përfunduara – kopje. Duke u bazuar në kërkesë e FDT, operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë ka ofruar një listë të projekteve si dhe referencat në fjalë ku në FDT nuk është kërkuar që për referenca të lëshuara nga OE (privat) ti bashkëngjiten edhe transaksionet bankare dhe po ashtu është kërkuar kontrata të natyrës së ngjajshme jo specifike. Por AK pasi ka kthyer procedurën në ri vlerësim për mes letrës B47 Letër Standarde e kërkesës për sqarimin e tenderit ka kërkuar sqarim nga OE të datës: 25.07.2023 ka kërkuar nga OE ti sjell kontratën dhe dëshmitë bankare për projektet:

1. "Furnizimi me pajisje për bujqësi dhe blegtori" ( OE Famis –CO-HC)

2. "Furnizim me koshere për bletë" (OE Komtel Projekt Engineering).

Operatori ekonomik është përgjigjur dhe ka ofrua dëshmi shtesë kontrata, farura si dhe transaksionet bankre, sa i përket pjese sa a janë kontrata fiktive për verifikim kjo është në diskrediton të AK –së (komisionit të vlerësimit dhe ZPP). Andaj për mendimin e ekspertit ky pretendim ankimor është pjesërisht i bazuar.

**Duke u bazuar në të gjitha pretendimet ankimore konkretisht në pretendimin e parë ankimor dhe pas shqyrtimit të tyre për mendimin e eksperti shqyrtues kjo lëndë duhet të kthehet në Ri vlerësim.**

*- Konstatimi i Panelit Shqyrtues -*

Paneli Shqyrtues konstatoi se nuk ekzistojnë elementet për parandalim të konfliktit të interesit, siç kërkohet në kuptim të nenit 11 të Rregullores për Punën e OSHP, prandaj analizoi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë të gjitha aktet dhe veprimet e palëve dhe konsideroi se nuk ka nevojë të konvokohet seanca publike me palë sepse ka prova të mjaftueshme për të vendosur sipas paragrafit 1, të nenit 24 të Rregullores së cituar. Paneli në ketë rast mori në konsideratë të gjitha pohimet ankimore, aktet dhe veprimet e AK dhe raportin e ekspertit.

Në fakt (natyrisht pavarësisht nga rekomandimet) Paneli vëren se procedura e prokurimit e cila është aplikuar në ketë rast është prezantuar në detaje në raportin e ekspertizës së ekspertit shqyrtues, duke i shpjeguar të gjitha fazat e procesit dhe veprimet e ndërmarra nga palët në kontekstin krahasues me aktet në fuqi, posaçërisht me Rregullat për Prokurim Publik.

Prandaj duke ju referuar nenit 104.1, të LPP, sipas të cilit kërkohet që procedura e shqyrtimit të zbatohet në mënyrë të shpejt, të ligjshme dhe efektive dhe duke i analizuar po ashtu në tërësinë e

tyre shkresat e kësaj lënde në kontekstin e këtij procesi të prokurimit, Paneli nuk e konsideroi të nevojshme ta shtjelloj sërish në detaje dhe pa nevojë në ketë rast secilin pretendim ankimor, përderisa të njëjtat në mënyrë specifike janë veçuar sidomos në vendimin e atakuar të autoritetit kontraktues. Krahas tjerash, në vendimin e atakuar të autoritetit kontraktues dhe në raportin e ekspertit shqyrtues janë dhënë shpjegime lidhur me pohimet ankimore. Paneli vëren se arsyet e dhëna në raportin e ekspertizës janë profesionale dhe të argumentuara pa vërejtje me prova materiale, pa nevojë që të përshkruhen sërish. Prandaj Paneli mbështet shpjegimet e ekspertit shqyrtues i cili ka shpjeguar në raportin e ekspertizës së tij si dhe mbështet rekomandimin e ekspertit që lënda të kthehet në ri-vlerësim.

*- Përfundim -*

Bazuar në të lartcekurat, Paneli shqyrtues konsideron se AK ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 59, 60 dhe 72 të LPP, të cituara në Ankesë. Paneli Shqyrtues konsideron se veprimet dhe aktet e AK, dhe vlerësimet e ekspertit shqyrtues lidhur plotësimin ose jo të kushteve të përshkruara si më sipër dhe pohimet ankimore në ketë rast përbejnë bazë të mjaftueshme që aktivitetit i prokurimit të kthehet sërish në ri-vlerësim sepse në të kundërtën do të bije ndesh me fushëveprimin e LPP dhe bazën argumentuese të pretendimeve ankimore, të cilat Paneli i vlerëson sipas vlerësimit të pavarur të tij në kuptim të nenit 104 lidhur me nenin 105 të LPP. Kthimi i një aktivitetit të prokurimit me bazë kontestuese ligjore ri-vlerësim, është në harmoni me nenin 1, të LPP, sipas të cilit, qëllimi i këtij Ligji është mes tjerash, cituar: "...të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji".

Lidhur me nenin 105, duke e pasur parasysh kërkesën e nenit 104, paragrafi 1, të Ligjit të cituar sipas të cilit, cituar: "Procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e drejtë, të ligjshme dhe efektive të lëndës..." Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Andaj nga të lartcekurat, paneli shqyrtues ne pajtim me nenin 117 të LPP-së vendosi si në dispozitv të këtij vendimi.

Kryetar i Panelit Shqyrtues

**Vedat Poterqoi**

**Këshillë juridike:**

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- AK - **KUVENDI KOMUNAL FUSHË KOSOVË**
- OE - **N.T.P.„Bletaria Egzoni"**
- Arkivës së OSHP-së: